REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE E MBROJTJES SOCIALE

KËRKESË PËR SHPREHJE INTERESI
SHËRBIME KONSULENCE

29 Tetor 2018

PËR

Ekspert për asistencë ligjore për popullatat vulnerable në kuadër të implementimit të ndërhyrjes "Mobilizimi social, forcimi i koordinimit, bashkëpunimi dhe lidhjes së komunitetit"

NJËSIA E MENAXHIMIT TË PROGRAMIT

"Përshkallëzimi dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së përgjigjes kombëtare ndaj HIV/SIDA-s"

Granti ALB C-MoH No 1433

Ministria e Shëndetësisë ka filluar zbatimin e Projektit të Fondit Global per AIDS, Tuberkulosit dhe Malarie, GFATM. Projekti i Fondit Global në Shqipëri do të mbështesë aktivitetet në fushat e parandalimit të HIV dhe TB, përforcimin e sistemit shëndetësor të shërbimit në të gjitha nivelet, rritjen e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve dhe ndërtimin e sistemeve të qëndrueshme për mbështetjen e aktiviteteve në të ardhmen. Në këtë kuadër, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nëpërmjet Njësisë së Menaxhimit të Programit fton të gjithë individët e interesuar për të shprehur interesin për Ekspert për asistencë ligjore për popullatat vulnerable në kuadër të implementimit të ndërhyrjes "Mobilizimi social, forcimi i koordinimit, bashkëpunimit dhe lidhjes së komunitetit"

Afati i fundit i aplikimit: 12.11.2018

email/web: globalfund.albania@gmail.com www.shendetesia.gov.al www.ccm-albania.al

Vendndodhja: Tiranë, Rr Naim Frashëri Nr 57
Kohëzgjatja: 90 ditë pune përgjatë periudhës Dhjetor 2018 –31 Dhjetor 2019.
Periudha e parashikuar e fillimit të punës: Dhjetor 2018.

1. Analiza e situatës

Problemet e HIV/AIDS dhe aspektet e trajtimit të tyre shumëdimensionale janë ende dukuri e re në Shqipëri. Shërbimet multisektoriale për njerezit që jetojnë me HIV/AIDS (NJJHA) ku përfshihen shërbimet e standartizuara per kujdes shendetesor, psiko-sociale, ato mbeshtetese, edukative, juridike lënë shumë për të dëshiruar. Pengesë kryesore mbetet stigma dhe diskriminimi ndaj NJJHA, që ndikon në vonesën në testimin për HIV, diagnozë të vonuar dhe qasjen në kujdes.

Në Shqipëri, janë evidente rastet e braktisjes, izolimit social, përballjes me stigmen dhe diskriminimin në të gjitha nivelet e shoqerise. NJJHA perballen me papunësinë ose riintegrimin profesional, me probleme financiare si pasojë e infektimit me HIV/AIDS.

Ligji Nr. 9952 për HIV/AIDS u rishikua dhe u miratua ne 14 korrik të vitit 2008. Ligji trajton aspektet juridike më te rendesishme të HIV/AIDS, përfshirë stigmën dhe diskriminimin, të drejten për mbajtjen e vendit të punës, dhenien e pëlqimit për marrjen e informacioneve, ruajtjen e informacionit të rezervuar, trajtimin falas, krijimin e “vendeve të sigurta” ku njerëzit të kenë mundesi të marrin trajtim, si edhe një mekanizem për ankesat.

Megjithatë, në sajë të fushatave të ndërgjegjesimit dhe advokimit, janë berë prezente shumë problematika që kërkojnë zgjidhje afatgjata dhe qendrueshmëri institucionale, të cilat duhet të venë në qendër të mirëqenies së përgjithshme dhe garantimit të të drejtave njerëzore të NJJHA, në lidhje me të drejtën e tyre për shëndet, shkollim, punësim, mbështetje, dhe përfshirje. Mungesa e informacionit, frika dhe stigma lidhur me këtë virus mungesa e modeleve rregulluese e sistemeve të mbeshtetjes dhe kujdesit, kanë qenë faktorë kyç për të plotësuar nevojat themelore të NJJHA, të shoqëruar shpesh nga diskriminimi, paragjykimi, dhe mungesa e mbështetjes.

Ndonëse ligjet anti-diskriminuese ekzistojnë, dhe pavaresisht mbështetjes nga një serë organizatash, anëtarë të komunitetit LGBT raportojnë nivele të larta të stigmës duke perfshirë abuzimin verbal dhe fizik.

Ka shumë të dhëna të kufizuara në lidhje me punonjëset e seksit në Shqipëri. Në Shqipëri, seksi me pagesë ndalohet me ligj, çka bën që ai të ushtrohet në mënyrë të paligjshme, duke u bërë një pengesë në ofrimin e shërbimeve parandaluese për këtë grup.

Reduktimi i stigmës dhe diskriminimit ndaj popullatave vulnerable është një nga objektivat e strategjisë kombëtare të HIV/AIDS dhe përfshin: Përmirësimin e kuadrit

ligjor për reduktimin e stigmës dhe diskriminimit; Fuqizimi i mekanizmave ligjor për ofruesit e shërbimeve; Fuqizimi i kapaciteve të mediave për pasqyrimin e çështjeve të lidhura me HIV/AIDS.

Në zbatim të strategjisë kombëtare, Programi i Fondit Global parashikon zbatimin e një sërë ndërhyrjesh te cilat synojnë reduktimin e stigmës dhe diskriminimit ndaj popullatave kyç dhe ofrimin e mbështetjes ligjore për këto grupe. Në këtë kuadër kërkohet konsulenca e një eksperti ligjor që do të kryejë detyrat si më poshtë.

2. Objektivi i shërbimi të konsulencës

- Ofrimi i ndihmes juridike falas (përgatitja e dokumentave ligjore ose shpjegimin e dispozitave ligjore) për popullatat kyç të mbuluara nga projekti, siç janë
    - njerëzit që jetojnë me HIV/AIDS (NJJHA)
    - meshkujt që kryejnë marrëdhënie seksuale me meshkuj (MSM),
    - personat që injektojnë droga (PWID),
    - punonjësit e seksit (SW),
    - komuniteti Rom,
    - të burgosurit etj,

- Bazuar në rezultatet e rasteve të trajtuara, si dhe analizën e dokumenteve ligjore ekzistues që lidhen me popullatat kyçe, të përgatisë një raport të plotë me analizën e rasteve të trajtuara dhe të japë rekomandime specifike praktike për zhvillimin e strategjive, ligjeve dhe akteve nënligjore

- Të marrë pjesë në takime me nënpërfituesit dhe stafin e projektit për të ndihmuar në aspektin ligjor nëse ka nevojë.

3. Kualifikimet

- Diplome universitare e avancuar (diplomë Master ose ekuivalent) në fushën e së drejtës.
- Eksperiencë pune në projektet e asistences juridike në lidhje me ofrimin e ndihmës për komunitetet e margjinalizuara
- Eksperience e mëparshme në kryerjen e vlerësimeve të nevojave dhe zhvillimit e kuadrit rregullator dhe ligjor.
- Njohuri të mira për aktivitetet e Fondit Global dhe fushat e ndërhyrjeve;
- Pervojë pune me organizatat qeveritare, ndërqeveritare dhe jo-qeveritare (CSO);
- Njohuri të shkelqyera të gjuhës angleze

- Diplomë në marrëdheniet ndërkombëtare, administratën publike ose fusha të ngjashme, e preferueshme;

4. Aftësitë

- Kapacitete planifikimi, aftësi analitike dhe implementuese
- Përvojë dhe sukses i provuar që punon me aktorë të ndryshëm, duke kërkuar aftësi vendimmarrëse me informacion të kufizuar dhe në afate të ngushta;
- Aftësia për të identifikuar hendeqet dhe riskun e implementimit dhe adresimin e tyre;
- Fleksibiliteti për të punuar nën presion dhe për të marrë vendime.

5.Dokumentet e kërkuara

- Letër motivimi
- Curriculum Vitae sipas formatit Europian
- Çdo dokument tjetër mbështetës për kualifikimet dhe eksperiencat në fushën e shërbimit.

6. Kriteret e përzgjedhjes

Kriteret e përzgjedhjes do të bazohen në ekperiencën individuale dhe kualifikimet.

- Kualifikimet e përgjithshme 40 pikë
- Eksperienca në fushën e shërbimit 60 pikë

Për çdo paqartësi lutemi shkruani në adresën globalfund.albania@gmail.com.

Dokumentet e nevojshme të dërgohen me email në adresën: globalfund.albania@gmail.com deri në datën 12.11.2018 orari zyrtar ora 16:00 me titull aplikimi *Shërbim konsulence per asistence ligjore për programin e Fondit Global*.